

Informacion: Përfshirja e Prezantimi i IServ në Shkollën Filllore

Duke dëshiruar, që të përmirësojmë komunikimin në shkollë midis mësuesve dhe nxënësve. Për këtë qëllim, ne do të japim mundësinë e përdorimit të programit **IServ**. Përdorimi dhe komunikimi me këtë program, do të bëhet i mundur për të gjithë mësuesit si dhe nxënëset e nxënësit nëpërmjet një Kodi/Qasje përkatëse, të veçantë për secilin onlajn /online .

Çfarë mund të bëj unë me programin IServ?

- të shkëmbej email dhe skedarë/datat
- të hyj me Video, në konferencë dhe biseda
- të jap apo përcjell ushtrime/detyra

Si mund të hyj në programin IServ?

Ju keni 2 mundësi për të përdorur programin IServ:

1. Juve, u nevojitet një PC ose Notebuk, me lidhje në internet. Një shfletues aktual/Browser duhet të instalohet në pajisje (p.sh. Firefox, Google Chrome,
2. Safari, Opera, ...)

ose

2. Mund të përdorni celularin/telefonin ose tabletën tuaj. Për ta bërë këtë, duhet të instaloni aplikacionin/App IServ.

Për pajisjet Apple: App Store

Scan

Për pajisjet Android: Programi Google Play

Scan



Si mundem unë të regjistrohem?

Së pari, ju duhet të jepni adresën në Iserv: www.lgs-rhede.de
Pastaj, shkruani emrin e fëmijës tuaj.

Emri i përdoruesit, është emri i fëmijës tuaj. Kjo është forma e drejtshkrimi: emri. mbiemri
(si për shembull: sara.müller)

Si **Fjalëkalimi** do të shkruani **datëlindjen** e fëmijës tuaj në këtë formë: Dita.Muaji.Viti i lindjes/
TT.MM.JJJJ (si për shembull: 02.09.2014)

Pastaj, duhet të vendosni një fjalëkalim të ri. Mbajeni mend ose shënojeni diku fjalëkalimin e ri: Nëse ju harroni fjalëkalimin tuaj, atëherë kontaktoni shkollën.

Ok, tani jam brënda, si të veprojmë më tej tani?

Në të majtë të linkut, do të gjeni zonat për komunikim dhe kontaktimin tuaj:

- **Email/imeil**

Secili mësues dhe të gjithë nxënësit, secili prej tyre ka një format të tillë të adresës së postës elektronike, si në vijim: vorname.nachname@gs-igs.de

(Emri.mbiemri@gs-igs.de)

- kjo është e pa përdorshme në gjuhën

shqipe.)

- **Dosjet /skedarët/Datein**

Këtu, do të gjeni ju të depozituara fletët e punës. Ekzistojnë dy zona, "E imja/personale " dhe "Grupi".

Skedari personal/ „E imja“ : Vetëm fëmija juaj, mund të përdori atë.

Skedari **Grupi**: këtu ruhen/gjinden fletët e punës për të gjithë klasën.

- **Mesazhet ose shkëmbimi i lajmeve**

mesazhi është një bashkëbisedim. Mësuesit si dhe nxënëset e nxënësit mund të bashkëbisedojnë ndërmjet tyre këtu.

- **Detyrat e shtëpisë**

Detyrat e shtëpisë. mund të bëhen këtu. Detyrave mund të dërgohen sipas një afat të përcaktuar kohor. Nxënëset dhe nxënësit mund të shohin detyrat e tyre këtu, si dhe t'i dërgojnë zgjidhjet e tyre. Pastaj, detyrat arrijnë tek mësuesi i tyre.

Provoni ju, se si funksionon IServ!

Hyni e provoni me guxim përreth. Ju nuk mund të prishni asgjë!

Ju, mund të gjeni ndihmë më të hollësishme direkt në faqen e internetit të prodhuesit **IServ** në këtë adresë : <https://iserv.eu>

A janë të dhënat personale të sigurt?

Mbrojtja dhe siguria e të dhënave private janë shumë të rëndësishme! Kjo firmë **IServ** zhvillon aktivitetin e saj në Gjermani. Asnjë e dhënë personale nuk ruhet në serverat jashtë vendit/Gjermanisë.

Komunikimi është i kyçur/i koduar.

Të dhënat personale do të fshihen kur fëmija juaj të largohet nga shkolla.

Shënim: Aufklärung

IServ- është një Platforme Elektronike e veçantë për sistemet Shkollore, mësues e nxënës